

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar**

**P5**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

*Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme*

Data 24.01.2026

1. Pasqyrat e mëposhtme të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse lidhen me tre entitete: Tirana sh.a, Prishtina sh.a dhe Shkupi sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025.

|  | Tirana sh.a<br>€ milion | Prishtina sh.a<br>€ milion | Shkupi sh.a<br>€ milion |
|--|-------------------------|----------------------------|-------------------------|
| Të hyrat   | 3,560                   | 1,550                      | 1,200                   |
| Kosto e shitjeve                                     | <u>(2,050)</u>          | <u>(900)</u>               | <u>(570)</u>            |
| Fitimi bruto   | 1,510                   | 650                        | 630                     |
| Shpenzimet operative                                 | (845)                   | (580)                      | (480)                   |
| Kosto financiare                                     | <u>(15)</u>             | <u>-</u>                   | <u>-</u>                |
| Fitimi para tatimit                                  | 650                     | 70                         | 150                     |
| Tatimi   | <u>(350)</u>            | <u>(110)</u>               | <u>(90)</u>             |
| <b>Fitimi për vitin</b>                              | <b>300</b>              | <b>(40)</b>                | <b>60</b>               |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:                 |                         |                            |                         |
| Përfitimi në rivlerësimin e pronës                   | <u>80</u>               | <u>-</u>                   | <u>-</u>                |
| <b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b> | <b>380</b>              | <b>(40)</b>                | <b>60</b>               |

**Informata shtesë:**

- i) Tirana sh.a bleu 210 milionë aksione të zakonshme me vlerë nominale prej €3 secila (që përfaqësojnë 70% të numrit të përgjithshëm të aksioneve të zakonshme) në Prishtina sh.a më 1 prill 2025, kur rezervat e tjera të Prishtina sh.a-së ishin €49 milionë dhe fitimet e mbajtura të Prishtina sh.a-së ishin €310 milionë. Shuma u ra dakord në €1,430 milionë. Kjo u përmbush me emetimin e 120 milionë aksioneve të zakonshme të Tirana sh.a-së me vlerën e drejtë prej €1,130 milionë, plus €300 milionë që do të paguheshin nga Tirana sh.a më 31 dhjetor 2025 nëse Prishtina sh.a arrin një objektiv fitimi (€80 milionë) deri në vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025. Elementi kontigjent i shpërblimit u regjistrua në vlerën e tij të drejtë prej €240 milionë më 1 prill 2025. Prishtina sh.a pësoi humbje të konsiderueshme për periudhën deri më 31 dhjetor 2025. Si pasojë, asgjë nuk është e pagueshme nga Tirana sh.a më 31 dhjetor 2025 sipas kësaj pjese të marrëveshjes. Tirana sh.a nuk ka bërë asnjë hyrje për të reflektuar këtë ndryshim në vlerën e drejtë të konsideratës kontigjente.
- ii) Në datën e blerjes së Prishtina sh.a, vlerat kontabël të pasurive të saj neto ishin të barabarta me vlerat e drejta, përveç një detyrimi kontigjent prej €10 milionë, siç është shpalosur në pasqyrat financiare të Prishtina sh.a-së, i cili kishte një vlerë të drejtë të vlerësuar prej €9 milionë. Pas blerjes, detyrimi është njohur nga Prishtina sh.a në librat e saj si €7 milionë. Injoroni implikimin e tatimit të shtyrë të këtij rregullimi.
- iii) Është politikë e grupit Tirana sh.a të vlerësojë interesat jo-kontrolluese (IJK) me vlerën e tyre të drejtë në datën e blerjes. Në atë datë, vlera e drejtë e IJK-së së Prishtina sh.a ishte €360 milionë. Për shkak të humbjeve të papritura të pësuar nga Prishtina sh.a gjatë vitit, më 31 dhjetor 2025 u krye një test dëmtimi dhe rezultoi se zëri i mirë ishte i dëmtuar me 40% të vlerës së blerjes. Tirana sh.a ngarkon dëmtimin e zërit të mirë në shpenzimet operative.

- iv) Më 1 tetor 2025, Tirana sh.a bleu 30% të aksioneve në Shkupi sh.a. Shuma u ra dakord në €120 milionë, e cila do të paguhej me para në dorë nga Tirana sh.a më 31 gusht 2026. Tirana sh.a ende nuk e ka regjistruar këtë shumë. Pas një performance të dobët të papritur pas blerjes, investimi u dëmtua për €1.5 milionë.
- v) Shitjet e mëposhtme ndërmjet grupit me kosto plus 62.5% u kryen gjatë tërë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2025:

|                               | <b>Shitjet</b>  | <b>Përfshirë në stoqet në fund të blerësit</b>              |
|-------------------------------|-----------------|---|
|                               | <b>€ milion</b> | <b>€ milion</b>   |
| Tirana sh.a te Shkupi sh.a    | 86              | 13<br>(të gjitha të blera në nentor dhe dhjetor nga Shkupi) |
| Prishtina sh.a te Tirana sh.a | 115             | 26  |

- vi) Të gjitha fitimet ose humbjet dhe zërat e tjerë të të ardhurave gjithëpërfshirëse ndodhin në mënyrë të njëtrajtshme, përveç nëse tregohet ndryshe. Çdo efekt i kontigjencave që lidhen me periudhën aktuale duhet të korigjohet kundrejt shpenzimeve operative.
- vii) Norma e aplikueshme e skontimit është 20% (faktori i skontimit 0.8333). Injoroni tatimin e shtyrë përveç nëse përcaktohet ndryshe.

**Kërkohet:**


**Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të grupit Tirana sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025. (20 pikë)**

**1. Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025.**

|  | <b>€ milion</b>   |
|--|-------------------|
| Të hyrat (3,560 + (1,550 x 9/12) - (115 x 9/12))                             | 4,636.25          |
| Kosto e shitjeve -(2,050 + (900 x 9/12) - (115 x 9/12) + 1.5(L15) + 10(L15)) | <u>(2,650.25)</u> |
| Fitimi bruto   | 1,986             |
| Shpenzimet operative (845 + (580 x 9/12) + 192(L12) - 240(L13) -2 (L13))     | (1,230)           |
| Kosto financiare (15 + 5 (L16))  | (20)              |
| Pjesa e fitimit të shoqërisë [(30% x 60 x 3/12) - 1.5 (dëmtimi i shoqërisë)] | <u>3.0</u>        |
| Fitimi para tatimit  | 739               |
| Tatimi (350 + (110 x 9/12))  | <u>(432.5)</u>    |
| <b>Fitimi për vitin</b>  | <b>306.5</b>      |
|  |                   |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:   |                   |
| Përfitimi në rivlerësimin e pronës   | <u>80</u>         |
| <b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>                         | <b>386.5</b>      |
|  |                   |
| Fitimi për vitin i atribuar:   |                   |
| Pronarëve të kompanisë prind (saldo balancuese (307.75 - (-68.85))           | 376.1             |
| Interesit jo-kontrollues (L17)   | <u>(69.6)</u>     |
|  | <b>306.5</b>      |
|  |                   |
| Total të ardhurat gjithëpërfshirëse atribuar:                                |                   |
| Pronarëve të kompanisë prind (saldo balancuese (387.75 - (-68.85))           | 456.1             |
| Interesit jo-kontrollues (L17)   | <u>(69.6)</u>     |
|  | <b>386.5</b>      |

**Llogaritjet:**

**1. Struktura e grupit**



**2. Zëri i mirë - Prishtina sh.a**

|   | <b>€ milion</b> | <b>€ milion</b> |
|---|-----------------|-----------------|
| Kosto e investimit:   |                 |                 |
| Emetimi i aksioneve   |                 | 1,130           |
| Konsiderata kontigjente                                     |                 | <u>240</u>      |
|   |                 | 1,370           |
| Vlera e drejtë e IJK-së në blerje                           |                 | <u>360</u>      |
|   |                 | 1,730           |
|   |                 |                 |
| Vlera e drejtë e neto pasuritë të identifikueshme të blera: |                 |                 |
| Kapitali aksionar (210m x 100/70 x €3)                      | 900             |                 |
| Fitimet e mbajtura  | 310             |                 |
| Rezervat tjera  | 49              |                 |
| Detyrimi kontigjent   | <u>(9)</u>      | <u>(1,250)</u>  |
| Zëri i mirë në blerje                                       |                 | 480             |
| Minus: dëmtimi (40% x 480)                                  |                 | <u>(192)</u>    |
| <b>Zëri i mirë në datën e raportimit</b>                    |                 | <b>288</b>      |

### 3. Anulimi i konsideratës kontigjente

- a) Anulimi i shumës fillestare kontigjente prej €240 raportohet si zvogëlim i shpenzimeve operative ne zgjidhje por mund të raportohet edhe si e ardhur operative.
- b) Vlera e drejtë e detyrimit kontigjent u njoh fillimisht në €9 milionë. Kjo u shlye më pas për €7 milionë, duke rezultuar në një fitim pas blerjes prej €2 milionë. Kjo raportohet gjithashtu si një zvogëlim i shpenzimeve operative por mund të raportohet edhe si e ardhur operative.

### 4. Eliminimi i shitjeve dhe blerjeve brenda grupit pas blerjes

Eliminoni plotësisht shitjet dhe blerjet brenda grupit pas blerjes (€115 milionë x9/12) nga të ardhurat e grupit dhe kostoja e shitjeve të grupit.

### 5. Fitimi i perealizuar në stoqe

- a) Në transaksion nga Investitori (Tirana sh.a) te Shoqëria (Shkupi sh.a) = €13 milionë x (1-1/62.5%) x 30% = €1.5 milionë. (Debi Kosto e shitjeve €1.5 milionë; Kredi Investim në shoqëri €1.5 milionë).
- b) Në transaksionin nga Dega (Prishtina sh.a) tek Kompania Prind (Tirana sh.a) = (€26 milionë x (1-1/62.5%)= €10 milionë. (Debi Kosto e shitjeve €10 milionë; Kredi Stoqet €10 milionë). IJK është prekur pasi Prishtina sh.a (dega) ishte anëtar i grupit që regjistroi fitimin.

### 6. Anulimi i skontimit në konsideraten e shtyrë në blerjen e Shkupi sh.a

|  | € milion   |
|--|------------|
| Në blerje (120 x 1/1.20)               | 100        |
| Anulimi i skontimit (20% x 100 x 3/12) | <u>5</u>   |
| <b>31 dhjetor 2025</b>                 | <b>105</b> |

### 7. Percaktimi i pjesës së fitimit/humbjes që i takon IJK-së

|   | € milion      |
|---|---------------|
| Prishtina sipas PFH & TTGj (40 x 9/12)    | (30)          |
| Minus fitimi i perealizuar në stoqe (L15) | (10)          |
| Minus humbja nga dëmtimi i zërit të mirë  | <u>(192)</u>  |
| Shuma e korigjuar                         | (232)         |
| Pjesa e IJK-së                            | 30%           |
| <b>Shuma e IJK-së</b>                     | <b>(69.6)</b> |

*Shënim:* Detyrimi kontigjent është kristalizuar, shlyer dhe njohur, kështu që nuk kërkohet përsëri rregullim.

2.

a) Elbasani sh.a bleu 100% të një dege (filiali), Rrogozhina sh.a, më 1 janar 2024. Vlera kontabël e pasurive të Rrogozhina sh.a në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit Elbasani sh.a më 31 dhjetor 2025, menjëherë para një rishikimi të dëmtimit, ishte si më poshtë:

|  | € milion   |
|--|------------|
| Zëri i mirë                                      | 1.4        |
| Marka tregtare (brendi)                          | 2.0        |
| Prona, fabrika dhe paisjet                       | 6.0        |
| Pasuritë qarkulluese (në shumën e rikuperueshme) | <u>2.4</u> |
|  | 11.8       |

Shuma e rikuperueshme e Rrogozhina sh.a u vlerësua në €9.6 milionë më 31 dhjetor 2025 dhe dëmtimi i investimit në Rrogozhina sh.a u konsiderua të jetë €2.2 milionë. Elbasani sh.a zbaton SNK 16 Prona, fabrika dhe pajisjet dhe SNK 36 Dëmtimi i pasurive në përgatitjen e pasqyrave të saj financiare.

**Kërkohet:**

**Duke supozuar se Rrogozhina sh.a përfaqëson një njësi gjeneruese të parasë, tregoni trajtimin në raportimi financiar të markës tregtare më 31 dhjetor 2025 në librat e Elbasani sh.a pas rishikimit për dëmtim. (5 pikë)**

b) Çështjet e mëposhtme ndikojnë te Struga sh.a në lidhje me grantet qeveritare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025.

- i) Qeveria e Kosovës vendosi të krijojë një zonë zhvillimi në Kaçanik dhe ofroi të kompensojë bizneset për kostot e tyre të zhvendosjes. Struga sh.a mori €30,000 për zhvendosjen e cila u përfundua në vitin 2025.
- ii) Për shkak se Struga sh.a nuk i përmbushi të gjitha kushtet e një grati tjetër të marrë në vitin 2024, €15,000 nga ky grant i marrë më parë dhe i kredituar plotësisht në fitim ose humbje duhej të rimbursohet në vitin 2025.
- iii) Struga sh.a gjithashtu me 1 janar 2025 mori €80,000 nga qeveria në lidhje me blerjen e pajisjeve. Pajisjet kushtuan €160,000 dhe pritet të zhvlerësohen gjatë jetës së tyre të dobishme prej tetë vitesh pa vlerë të mbetur në fund të tetë viteve.

**Kërkohet:**

**Llogaritni se sa nga shumat e granteve qeveritare duhet të përfshihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe në pasqyrën e pozitës financiare të Struga sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025. (6 pikë)**

c) Suhareka sh.a me 1 janar 2025 hyn në një kontratë pësevjeçare të lizingut të një ndërtese e cila ka jetë të mbetur të përdorimit prej 5 viteve. Pagesat e lizingut janë €60,000 në vit, të pagueshme në fund të çdo viti (31 dhjetor).

Suhareka sh.a shkakton kosto direkte fillestare lidhur me lizingun prej €10,000. Nuk ka transfer të pasurisë në fund të lizingut dhe nuk ka opcion të blerjes. Norma e interesit e nënkuptuar në lizing nuk është e përcaktueshme menjëherë por norma shtesë (rritëse) e huamarrjes të lizingmarrësit është 8%.

| <b>Periudha</b> | <b>Faktori i skontimit (8%)</b> |
|-----------------|---------------------------------|
| 1               | 0.9259                          |
| 2               | 0.8573                          |
| 3               | 0.7938                          |
| 4               | 0.7350                          |
| 5               | 0.6806                          |

**Kërkohet:**

**Rekomandoni drejtorët e Suhareka sh.a se si të kontabilizohet kontrata e lizingut me e më 31 dhjetor 2025 në përputhje me SNRF 16 *Lizingjet*. (5 pikë)**

d) Objektivi i SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente* është të sigurojë që kriteret e duhura të njohjes dhe bazat e matjes të zbatohen për provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontingjente dhe që informacioni i mjaftueshëm të shpaloset në shënimet e pasqyrave financiare për t'u mundësuar përdoruesve të kuptojnë natyrën, kohën dhe shumën e tyre.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni "Detyrimin Kontigjent" dhe "Pasurinë Kontigjente" siç përdoren në deklaratën e mësipërme. (4 pikë)**

2.

a) Humbja nga dëmtimi për njësinë gjeneruese të parasë është €2.2 milionë (€11.8 milionë - 9.6 milionë). Humbja nga dëmtimi fillimisht i shpërndahet saldës së zërit të mirë prej €1.4 milionë. Humbja nga dëmtimi e pashpërndarë është €0.8 milionë. Kjo i ndahet markës tregtare dhe pasurive jo-qarkulluese bazuar në vlerat e tyre kontabël.

|                            | € milion |
|----------------------------|----------|
| Marka tregtare (brendi)    | 2        |
| Prona, fabrika dhe paisjet | <u>6</u> |
|                            | 8        |

$2/8 \times €0.8 = 0.2$  humbja që do t'i shpërndahet vlerës kontabël të markës së re tregtare = €2 milion - €0.2 milion = €1.8 milion.

### b) Trajtimi i grantit qeveritar

|   | PFHAGJ        | PPF           |
|---|---------------|---------------|
| Kostot e zhvendosjes (granti i të hyrave)                 | kredi €30,000 |               |
| Ripagimi i grantit  | debi €15,000  |               |
| Granti i paisjes  |               | kredi €80,000 |
| Amortizimi i të ardhurave të shtyera nga granti i paisjes | kredi €10,000 | debi €10,000  |

Saldo e të ardhurave të shtyera në PPF është €70,000 me 31 dhjetor 2025.

c) Detyrimi ndaj lizingut me 1 janar 2025 matet sipas vlerës së tanishme të pagesave të mbetura:

|   |                        |                 |
|---|------------------------|-----------------|
| 1 | $0.9259 \times 60,000$ | = 55,554        |
| 2 | $0.8573 \times 60,000$ | = 51,438        |
| 3 | $0.7938 \times 60,000$ | = 47,628        |
| 4 | $0.7350 \times 60,000$ | = 44,100        |
| 5 | $0.6806 \times 60,000$ | = <u>40,836</u> |
|   |                        | <b>239,556</b>  |

Pasuria me të drejtë të përdorimit = 239,556 + 10,000 = 249,556

### Me 31 dhjetor 2025

#### Pasqyra e fitimit ose humbjes

Shpenzimet e zhvlerësimit ( $249,556 / 5$  vite) = 49,911.20

Shpenzimet e interesit ( $239,556 \times 8\%$ ) = 19,164.48

#### Pasqura e pozitës financiare

*Pasuritë jo-qarkulluese*

Pasuria me të drejtë të përdorimit ( $249,556 - 49,911.20$ ) = 199,644.80

*Detyrimet afatgjata*

Detyrimet ndaj lizingut ( $239,556 + 19,164.48 - 60,000 - 55,554$ ) = 143,166.48

*Detyrimet afatshkurta*

Detyrimet ndaj lizingit ( $60,000 \times 0.9259$ ) = 55,554

d)

Detyrim kontigent:

- një detyrim i mundshëm në varësi të ndodhjes së ndonjë ngjarjeje të pasigurt në të ardhmen, ose
- një detyrim aktual, por pagesa nuk është e mundshme ose shuma nuk mund të matet me besueshmëri.

Pasuri kontigjente:

- një pasuri e mundshme që rrjedh nga ngjarjet e kaluara, dhe
- ekzistenca e të cilave do të konfirmohet vetëm nga ndodhja ose mosndodhja e një ose më shumë ngjarjeve të pasigurta në të ardhmen, të cilat nuk janë tërësisht nën kontrollin e entitetit.

3. Peja sh.a përgatit pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNRF-të. Më poshtë janë pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025 dhe pasqyra e pozitës financiare në atë datë, si dhe pasqyra krahasuese e pozitës financiare më 31 dhjetor 2024.

**Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025**

|                                   | €000             |
|-----------------------------------|------------------|
| Të ardhurat                       | 1,656,000        |
| Kosto e shitjes                   | <u>(745,200)</u> |
| Fitimi bruto                      | 910,800          |
| Të hyrat tjera                    | 15,000           |
| Shpenzimet administrative         | (409,860)        |
| Kosto e shperndarjes              | <u>(136,620)</u> |
| Fitimi para interesit dhe tatimit | 379,320          |
| Kosto e financimit                | <u>(3,232)</u>   |
| Fitimi para tatimit               | 376,088          |
| Shpenzimet e tatimit në fitim     | <u>(9,462)</u>   |
| <b>Fitimi i vitit</b>             | <b>366,626</b>   |

**Pasqyra e pozitës Financiare më 31 dhjetor**

|                                      | 2025           | 2024          |
|--------------------------------------|----------------|---------------|
| <b>Pasuritë</b>                      |                |               |
| <i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>      | <b>€000</b>    | <b>€000</b>   |
| Prona, fabrika & paisjet             | 33,210         | 23,260        |
| Prona investuese                     | 28,500         | 28,000        |
| Pasuritë e paprekshme                | <u>124</u>     | <u>155</u>    |
|                                      | 61,834         | 51,415        |
| <i>Pasuritë qarkulluese</i>          |                |               |
| Stoqet                               | 15,700         | 5,680         |
| Të arkëtueshmet tregtare             | 82,800         | 10,765        |
| Paraja                               | 16,712         | 152           |
| Banka                                | <u>304,437</u> | <u>5,950</u>  |
|                                      | <u>419,649</u> | <u>22,547</u> |
| <b>Total pasuritë</b>                | <b>481,483</b> | <b>73,962</b> |
| <b>Ekuiteti &amp; detyrimet</b>      |                |               |
| <i>Ekuiteti:</i>                     |                |               |
| Kapitali aksionar                    | 30,000         | 25,000        |
| Fitimet e mbajtura                   | 373,526        | 11,300        |
| Teprica e rivlerësimit               | <u>862</u>     | <u>1,262</u>  |
|                                      | 404,388        | 37,562        |
| <i>Detyrimet afatgjata:</i>          |                |               |
| 15% obligacion i ripagueshem në 2028 | 20,432         | 20,200        |
| Tatimi i shtyrë                      | 3,762          | 2,300         |
| <i>Detyrimet afatshkurta:</i>        |                |               |
| Të pagueshmet tregtare & të tjera    | 46,401         | 7,600         |
| Tatimi i pagueshëm                   | <u>6,500</u>   | <u>6,300</u>  |
| <b>Ekuiteti &amp; detyrimet</b>      | <b>481,483</b> | <b>73,962</b> |

**Informata shtesë:**

- i) Shpenzimet e zhvlerësimit për pasuritë jo-qarkulluese të prekshme të njohura për vitin janë €8,804,000. Nuk ka pasur blerje ose shitje/largim të asnjë prej pasurive jo-qarkulluese të prekshme gjatë vitit.
- ii) Rishikimi i dëmtimit është ndërmarrë për njërën nga paisjet e kompanisë që ka një vlerë kontabël prej €1,500,000, por shuma e rikuperueshme e vlerësuar në datën e rishikimit të dëmtimit ishte €745,000. Rezultati i rishikimit të dëmtimit është kontabilizuar saktë në pasqyrat financiare të mësipërme në përputhje me SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*.
- iii) Një nga automjetet e kompanisë u përfshi në një aksident gjatë vitit dhe u dëmtua përtej riparimit si rezultat i aksidentit. Vlera kontabël e automjetit ishte €562,000. Ky automjet është fshirë nga llogaria në pasqyrat financiare të mësipërme.
- iv) Kompania gjithashtu shiti një nga paisjet e saj e cila ka qenë në përdorim për njëfarë kohe tani për një shumë prej €850,000. Vlera kontabël e paisjes në datën e shitjes është €689,000. Çdo fitim ose humbje nga shitja e pasurive jo-qarkulluese përfshihet në të ardhura të tjera. Një fabrike e re prodhimi u ble gjithashtu nga kompania në nëntor 2025 me koston prej €8,640,000 me afat pagese prej 90-ditëve. Kjo pagesë përfshihet në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera. Prona investuese e kompanisë mbahet me vlerën e drejtë. Nuk ka pasur blerje ose shitje të pronës investuese gjatë vitit.
- v) Obligacioni 15% u emetua në janar 2024 me një vlerë nominale prej €20,000 për një afat pagese prej pesë (5) vitesh, i ripagueshëm me një prim prej 5%. Norma efektive e interesit vlerësohet në 16% në vit. Detyrimi është matur dhe trajtuar saktë me koston e amortizuar duke përdorur SNRF 9 *Instrumentet Financiare*. Kostoja e financimit në pasqyrën e fitimit ose humbjes lidhet tërësisht me këtë obligacion.
- vi) Nuk ka pasur rivlerësim të asnjë prej pasurive jo-qarkulluese të kompanisë gjatë vitit. Ndryshimi në tepricën e rivlerësimit përfaqëson pjesën e realizuar nga kompani gjatë vitit nëpërmjet përdorimit të pasurive të rivlerësuara. Shuma e realizuar është ngarkesa e tepërt e zhvlerësimit të shkaktuar sipas modelit të rivlerësimit në krahasim me ngarkësen e zhvlerësimit sipas modelit të koston, siç parashikohet nga SNK 16 *Prona, fabrika dhe pajisjet*.

**Kërkohet:**

Duke përdorur SNK 7 *Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme*, përgatitni pasqyrën e rrjedhës së parasë të Peja sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025. (20 pikë)

**Peja sh.a**  
**Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025**

|   | €'000          | €'000           |
|---|----------------|-----------------|
| <i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative:</i>                          |                |                 |
| Fitimi para tatimit   |                | 376,088         |
| Korigjimet për:   |                |                 |
| Kosto financiare  | 3,232          |                 |
| Zhvlerësimi   | 8,804          |                 |
| Amortisimi i pasurive të paprekshme (155-124)                               | 31             |                 |
| Dëmtimi (745-1,000)   | 755            |                 |
| Shlyerja e automjetit   | 562            |                 |
| Fitimi nga shitja (850-689)   | (161)          |                 |
| Ndryshimet në vlerën e drejtë të pronës investuese (28,500-28,000)          | <u>(500)</u>   |                 |
|   |                | <u>12,723</u>   |
| Paraja e gjeneruar nga operacionet para korigjimeve të kapitalit qarkullues |                | 388,811         |
| <i>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</i>                                  |                |                 |
| Rritja në stoqe (15,700 -5,680)   | (10,020)       |                 |
| Rritja në të arkëtueshmet tregtare (82,800-10,765)                          | (72,035)       |                 |
| Rritja në të pagueshmet tregtare [(46,401-8,640)-7,600]                     | <u>30,161</u>  | <u>(51,894)</u> |
| Paratë neto operative para interesit dhe tatimit                            |                | 336,917         |
| Interesi i paguar (L11)   | (3,000)        |                 |
| Tatimi i paguar (L12)   | <u>(7,800)</u> | <u>(10,800)</u> |
| <b>Neto paraja nga aktivitetet operative</b>                                |                | <b>326,117</b>  |
| <i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese:</i>                         |                |                 |
| Paraja e paguar për blerjen e PFP (L13)                                     | (12,120)       |                 |
| Arkëtimet nga shitja e PFP  | <u>850</u>     |                 |
| <b>Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>                     |                | <b>(11,270)</b> |
| <i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese:</i>                         |                |                 |
| Emetimi i aksioneve (30,000 - 25,000)                                       | 5,000          |                 |
| Dividenda e paguar (L14)  | <u>(4,800)</u> |                 |
| <b>Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>                     |                | <b>200</b>      |
| Neto rritja në paranë dhe ekuivalentët e parasë                             |                | 315,047         |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 1 janar 2025                            |                | <u>6,102</u>    |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 31 dhjetor 2025                         |                | 321,149         |
| <b>Llogaritjet:</b>   |                |                 |
| <b>1. Interesi i paguar</b>   | <b>€'000</b>   |                 |
| Saldo në fillim   | 20,200         |                 |
| Interesi me 16% (F&H)   | <u>3,232</u>   |                 |
|   | 23,432         |                 |
| Saldo në fund   | <u>20,432</u>  |                 |
|   | <b>3,000</b>   |                 |

|  |                |
|--|----------------|
| <b>2. Tatimi i paguar</b>                      | <b>€ 000</b>   |
| Saldo në fillim (6,300 + 2,300)                | 8,600          |
| F&H  | <u>9,462</u>   |
|  | 18,062         |
| Saldo në fund (6,500 +3,762)                   | <u>10,262</u>  |
|  | <b>7,800</b>   |
| <br>   |                |
| <b>3. Prona, fabrika &amp; paisjet</b>         | <b>€ 000</b>   |
| Saldo në fillim                                | 23,260         |
| Zhvlerësimi                                    | (8,804)        |
| Dëmtimi  | (755)          |
| Shlyerja e pasurisë                            | (562)          |
| Shitja e PFP                                   | (689)          |
| Blerja me afat pagese                          | <u>8,640</u>   |
|  | 21,090         |
| Saldo në fund                                  | <u>33,210</u>  |
| <b>Blerja e PFP</b>                            | <b>12,120</b>  |
| <br>   |                |
| <b>4. Pagesa e dividendës</b>                  | <b>€ 000</b>   |
| Fitimet e mbajtura saldo në fillim             | 11,300         |
| Fitimi i vitit                                 | 366,626        |
| Teprica e rivlerësimit e realizuar (1,262-862) | <u>400</u>     |
|  | 378,326        |
| Saldo në fund                                  | <u>373,526</u> |
|  | <b>4,800</b>   |

4.

a) Zëri i mirë negativ bazohet në konceptin kontabël të zërit të mirë, një pasuri e paprekshme që krijohet përmes raporteve të mira midis biznesit dhe klientëve të tij.

- Përmes ndërtimit të reputacionit (ndoshta përmes fjalëve të mira të përhapura) për produkte të kualitetit të lartë apo standarde të larta të shërbimit
- Përmes përgjigjeve të menjëhershme dhe ndihmuese në pyetjet dhe ankesat e konsumatorëve
- Përmes personalitetit të stafit dhe sjelljes së tyre ndaj konsumatorëve.

**Kërkohet:**

**Në pajtim me SNRF 3 *Kombinimet e biznesit*:**

- i) Përshkruani shkurtimisht se çfarë është zëri i mirë pozitiv dhe negativ. (1 pikë)**
- ii) Identifikoni tre (3) faktorë që shpjegojnë zërin e mirë negativ dhe tregoni trajtimin kontabël për zërin e mirë negativ në pasqyrat financiare të konsoliduara, kur ai ekziston. (5 pikë)**

b) SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientët*, përshkruan modelin e të hyrave në të cilin parimi kryesor është që një entitet duhet të njohë të hyrat në atë mënyrë që të pasqyrojë transferimin e mallrave ose shërbimeve të premtuara ndaj klientit, me një vlerë që reflekton shpërblimin (pagesën) që entiteti pret të përfitojë në këmbim të këtyre mallrave ose shërbimeve.

Prespa sh.a është një furnizues i shërbimeve të ndërtimit për klientë të ndryshëm dhe në fund të vitit të saj më 31 dhjetor 2025, kishte të dhëna për tre (3) projekte ndërtimi që ishin në zhvillim e sipër, siç jepet më poshtë:

Punimet e ndërtimit për të tre (3) projektet filluan më 1 tetor 2024 dhe pritej të përfundonin deri më 31 shtator 2027. Çdo projekt përfaqëson një kontratë të veçantë.

Politika e Prespa sh.a-së është të masë përmbushjen e detyrimit të performancës duke përdorur metodën e inputit.

|  | <b>Projekti 1</b> | <b>Projekti 2</b> | <b>Projekti 3</b> |
|--|-------------------|-------------------|-------------------|
|  | <b>€'000</b>      | <b>€'000</b>      | <b>€'000</b>      |
| Total çmimi i kontratës                                | 52,500            | 129,500           | 31,500            |
| Kostot e shkaktuara deri me datë                       | 18,900            | 126,000           | 26,950            |
| Vlerësimi i kostove të mbetura deri në përfundim       | 23,100            | 17,500            | 11,550            |
| Shumat e faturura për punën e çertifikuar deri me datë | 15,000            | 97,500            | 12,900            |
| Paraja e pranuar deri me datë                          | 12,750            | 97,500            | 10,900            |

**Kërkohet:**

- i) Shpjegoni dy (2) metoda që mund të përdoren në vlerësimin e shkallës së përmbushjes së detyrimit të performancës përgjatë kohës në përputhje me SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientët*. (4 pikë)**
- ii) Shpjegoni efektin e kontratave të mësipërme në pasqyrat financiare të Prespa sh.a-së për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025. (10 pikë)**

2.

(a)

**(i) Përshkrim i shkurtë i zërit të mirë pozitiv dhe negativ**

Kur kostoja e kombinimit biznesor është më e madhe se pasuritë neto të blera, investitori ka paguar për diçka më shumë se pasuritë neto të biznesit të blerë. Diferenca quhet zëri i mirë dhe matet në përputhje me SNRF 3 *Kombinimet biznesore - i rishikuar*. Zëri i mirë i blerë është pozitiv kur kostoja e investimeve tejkalon vlerën e drejtë neto të pasurive të identifikueshme, detyrimeve dhe detyrimeve kontigjente. Në përputhje me SNRF 3 *Kombinimet biznesore*, zëri i mirë negativ ndodh kur pasuritë neto të blera tejkalojnë koston e investimit.

**(ii) Faktorët që shpjegojnë zërin e mirë negativ dhe trajtimi kontabël**

1. Blerësi mund të jetë më i mirë në negociatat e konsideratës së blerjes sesa i shitësi.
2. Shitësi nuk ka dijeni për vlerën e biznesit të tij para dhe gjatë transaksionit të shitjes.
3. Shitësi është i detyruar të shesë në një transaksion shitjeje me forcë

Zëri i mirë i blerë pozitiv kapitalizohet në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar dhe i nënshtrohet një testi dëmtimi çdo vit. Testi pasues i dëmtimi ngarkohet në fitim ose humbje si shpenzim. Testet e dëmtimi kryhen të paktën në fund të çdo viti. Çdo humbje nga dëmtimi që rezulton njihet së pari kundrejt zërit të mirë të konsoliduar. Megjithatë, zëri i mirë i blerë nëse është negativ nuk kapitalizohet pasi përfaqëson një fitim për blerësin dhe për këtë arsye SNRF 3 *Kombinimet biznesore* kërkon që ai të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes menjëherë pas rivlerësimit dhe konfirmimit.

(b)

**(i)** Sipas SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientët*, ekzistojnë dy metoda që përdoren për të përcaktuar shkallën e përmbushjes së detyrimeve të performancës në një kontratë, përkatësisht: (i) metoda e inputit dhe (ii) metoda e daljes.

Metodat e inputit njohin të hyrat në baza të iputeve të entitetit, të tilla si orët e punës, resurset e konsumuara, kostot e shkaktuara. Nëse e përdorurim një metodë të bazuar në kosto, kostot e shkaktuara duhet të kontribuojnë në progresin e entitetit për përmbushjen e obligimit për performancë.

Metoda e inputit përdoret për të përcaktuar shkallën e përmbushjes së detyrimit të performancës duke llogaritur kostot e shkaktuara në një datë të caktuar si përqindje e kostove totale të vlerësuara të kontratës. Llogaritja bëhet sipas formulës më poshtë:

*Kostot e shkaktuara deri më sot / kostot totale të vlerësuara të kontratës x 100*

Metodat e outputit njohin të hyrat në baza të vlerës për klientin të mallrave ose shërbimeve të transferuara. Ato përfshijnë anketime të performancës së përfunduar, vlerësime të njesive të prodhuara apo dërguara etj.

Metoda e outputit përdoret për të përcaktuar shkallën e përmbushjes së detyrimit të performancës duke llogaritur vlerën e punës së çertifikuar si përqindje e të ardhurave totale të vlerësuara të kontratës. Llogaritja bëhet sipas formulës më poshtë:

*Vlera e punës së çertifikuar deri më sot / çmimi i kontratës x 100*

(ii) Më 31 dhjetor 2025, projektet e Prespa sh.a nuk do të ishin ende të përfunduara, prandaj lind nevoja për të përcaktuar shkallën e përmbushjes së detyrimeve të performancës së secilit projekt, që do të përdoret në përcaktimin e shumave që i atribuohen periudhës aktuale kontabël.

Më poshtë janë përqindjet e përfundimit për secilin projekt:

|   | Projekti 1<br>€'000 | Projekti 2<br>€'000 | Projekti 3<br>€'000 |
|---|---------------------|---------------------|---------------------|
| Kostot e shkaktuara/total kostot e vlerësuara x 100 |                     |                     |                     |
| 18,900/42,000x100                                   | 45%                 |                     |                     |
| 126,000/143,500x100                                 |                     | 88%                 |                     |
| 26,950/38,500x100                                   |                     |                     | 70%                 |

Për të llogaritur shumat që i atribuohen pasqyrës së fitimit ose humbjes së vitit aktual dhe pasqyrës së pozitës financiar, fitimi i përgjithshëm i vlerësuar për tre (3) projektet duhet të përcaktohet si më poshtë:

|   | Projekti 1<br>€'000 | Projekti 2<br>€'000 | Projekti 3<br>€'000 |
|---|---------------------|---------------------|---------------------|
| Të hyrat totale të vlerësuara nga kontakti  | 52,500              | 129,500             | 31,500              |
| Minus kostot e shkaktuara deri me datë      | (18,900)            | (126,000)           | (26,950)            |
| Minus kostot e vlerësuara deri në përfundim | <u>(23,100)</u>     | <u>(17,500)</u>     | <u>(11,550)</u>     |
| Total fitimi/(humbja) e vlerësuar           | 10,500              | (14,000)            | (7,000)             |

Projekti 1 pritet të jetë përgjithësisht fitimprurës dhe për këtë arsye shumat që i atribuohen fitimit ose humbjes për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 do të llogariten të gjitha bazuar në përqindjen e përfundimit.

Projekti 2 dhe projekti 3 pritet të sjellin humbje kur të përfundojnë. Kjo do të thotë që humbja totale e vlerësuar do të njihet menjëherë dhe vetëm të hyrat do të njihen bazuar në përqindjen e përfundimit, ndërsa kostoja e shitjeve do të jetë shifra balancuese (diferenca midis të hyrave dhe humbjeve të përgjithshme të vlerësuara).

Më poshtë janë shumat që duhen të paraqiten në fitim ose humbje për secilin projekt::

|   | Projekti 1<br>€'000 | Projekti 2<br>€'000 | Projekti 3<br>€'000 |
|---|---------------------|---------------------|---------------------|
| Të hyrat  |                     |                     |                     |
| (45%x52,500); (88%x129,500); (70%x31,500)           | 23,625              | 113,960             | 22,050              |
| Kosto e shitjeve (45%x42,000); (sal bal); (sal bal) | <u>(18,900)</u>     | <u>(127,960)</u>    | <u>(29,050)</u>     |
| <b>Fitimi/(humbja)</b>                              | <b>4,725</b>        | <b>(14,000)</b>     | <b>(7,000)</b>      |

Shumat e mëposhtme do të njihen në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2025:

|                                       | Projekti 1<br>€'000 | Projekti 2<br>€'000 | Projekti 3<br>€'000 |
|---------------------------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| Fitimi/(humbja) e njohur deri në datë | 4,725               | (14,000)            | (7,000)             |
| Plus kosto deri në datë               | <u>18,900</u>       | <u>126,000</u>      | <u>26,950</u>       |
|                                       | 23,625              | 112,000             | 19,950              |
| Minus shumat e faturura               | <u>(15,000)</u>     | <u>(97,500)</u>     | <u>(12,900)</u>     |
| <b>Pasuri e kontratës</b>             | <b>8,625</b>        | <b>14,500</b>       | <b>7,050</b>        |

Më 31 dhjetor 2025, Prespa sh.a do të njohë gjithashtu të arkëtueshmet nën pasuritë qarkulluese nga projekti 1 dhe projekti 3, pasi shumat e marra janë më të vogla se ato të faturuara tashmë si më poshtë:

|                    | <b>Projekti 1</b> | <b>Projekti 3</b> |
|--------------------|-------------------|-------------------|
|                    | <b>€'000</b>      | <b>€'000</b>      |
| Shumat e faturuara | 15,000            | 12,900            |
| Minus arkëtimet    | <u>(12,750)</u>   | <u>(10,900)</u>   |
| Të arkëtueshmet    | 2,250             | 1,000             |

Pasuritë e kontratës që do të shfaqen nën pasuritë qarkulluese janë: projekti 1, €8.625 milionë; projekti 2, €14.5 milionë dhe projekti 3, €7.05 milionë. Për më tepër, shumat e arkëtueshme nga klientët (diferenca midis shumave të faturuara dhe parave të marra) do të shfaqen nën pasuritë qarkulluese në pasqyrën e pozitës financiare për projektin 1, €2.25 milionë dhe projektin 3, €1 milion. Asnjë shumë e arkëtueshme nga projekti 2 pasi shuma e fatuar është e barabartë me shumën e marrë.

5. Prizreni sh.a. është një prodhues i mobiljeve të zyrës. Drejtori Ekzekutiv është i kënaqur me performancën e kompanisë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025. Ka pasur përmirësim masiv dhe të vazhdueshëm në performancë në të kaluarën e afërt. Megjithatë, Drejtori Financiar e ka këshilluar Drejtorin Ekzekutiv se një vlerësim më i mirë i performancës së kompanisë do të arrihej nëse performanca e saj krahasohej me kompanitë e tjera në sektor. Që atëherë, Drejtori Financiar ka mbledhur të dhëna mbi koeficientët e sektorit të prodhimit të mobiljeve të zyrës nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar bazuar në vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 si më poshtë:

|  |          |
|--|----------|
| Marzha e fitimit bruto                 | 22%      |
| Marzha e fitimit neto                  | 5%       |
| Mbulimi i interesit                    | 1.6 herë |
| Fitimi për aksion (FPA)                | €0.80    |
| Leverazhi (Borxh : Ekuitet)            | 42%      |
| Koeficienti i qarkullimit              | 1.6:1    |
| Kthimi në kapitalin e angazhuar (KNKA) | 17.9%    |
| Qarkullimi i pasurisë                  | 1.9 herë |

(Për qëllime të llogaritjes së koeficientit të leverazhit, borxhi është përcaktuar të përfshijë të gjitha detyrimet financiare që bartin interes, detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata).

Pasqyrat financiare të përmbledhura të Prizreni sh.a. janë si më poshtë:

**Pasqyra e fitimi ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025.**

|                               |                  |
|-------------------------------|------------------|
|                               | <b>€'000</b>     |
| Të hyrat                      | 156,250          |
| Kosto e shitjeve              | <u>(129,500)</u> |
| Fitimi bruto                  | 26,750           |
| Shpenzimet operative          | (14,500)         |
| Kosto financiare              | <u>(4,500)</u>   |
| Fitimi para tatimit           | 7,750            |
| Shpenzimet e tatimit në fitim | <u>(2,500)</u>   |
| <b>Fitimi për vitin</b>       | <b>5,250</b>     |

**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2025.**

|                                 |                |
|---------------------------------|----------------|
| <b>Pasuritë:</b>                | <b>€'000</b>   |
| <i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i> |                |
| Prona                           | 20,250         |
| Fabrikat                        | <u>62,000</u>  |
|                                 | 82,250         |
| Pasuritë qarkulluese:           | <u>41,000</u>  |
| <b>Total pasuritë</b>           | <b>123,250</b> |

**Ekuiteti dhe detyrimet:**

|                                     |               |
|-------------------------------------|---------------|
| <i>Ekuiteti:</i>                    |               |
| Aksionet e zakonshme prej €1 secila | 22,500        |
| Teprica e rivlerësimit              | 10,000        |
| Fitimet e mbajtura                  | <u>26,500</u> |
|                                     | 59,000        |

*Detyrimet afatgjata:*

|                         |               |
|-------------------------|---------------|
| 10% notë kreditor       | 25,000        |
| Detyrimet ndaj lizingut | <u>16,000</u> |
|                         | 41,000        |

*Detyrimet afatshkurta:*

|                                     |                |
|-------------------------------------|----------------|
| Të pagueshmet tregtare              | 12,500         |
| Detyrimet ndaj lizingut             | 5,250          |
| Tatimi i pagueshëm                  | <u>5,500</u>   |
|                                     | <u>23,250</u>  |
| <b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b> | <b>123,250</b> |

Informatat shtesë të mëposhtme janë të rëndësishme:

- i) Në koston e fabrikës përfshihet fabrika e marrë me lizing me vlerë prej €30.5 milionë. Të gjitha detyrimet e lizingut duhet të trajtohen si borxh në llogaritjen e kthimi në kapitalin e angazhuar (KNKA) dhe të leverazhit.
- ii) Teprica e rivlerësimit lidhet me pronën. Artikuj të rinj të fabrikave u blenë në korrik 2025.
- iii) Leverazhi llogaritet si borxh\ekuitet, ndërsa kapitali i angazhuar për qarkullimin e pasurisë duhet të jetë totali i pasurive minus detyrimet afatshkurta.

**Kërkohet:**

- a) Përgatitni për Prizreni sh.a koeficientët ekuivalente me ato të sektorit të saj. (8 pikë)
- b) Analizoni performancën dhe pozitën financiare të Prizreni sh.a-së për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 në krahasim me mesataret e sektorit. (12 pikë)

[Total: 20 pikë]

5.

(a)

| Koeficienti                            | Llogaritjet  | Prizreni sh.a | Mesatarja e sektorit |
|--|--|---------------|----------------------|
| Marzha e fitimit bruto                 | $(26,750/156,250) \times 100$                          | 17.1%         | 22%                  |
| Marzha e fitimit neto                  | $(5,250)/156,250 \times 100$                           | 3.4%          | 5%                   |
| Mbulimi i interesit                    | $(26,750-14,500)/4,500$                                | 2.7 herë      | 1.6 herë             |
| Fitimi për aksion (FPA)                | $(\text{€}5,250/22,500 \text{ aksione})$               | €0.23         | €0.80                |
| Leverazhi (Borxh : Ekuitet)            | $(25,000+16,000+5,250/59,000) \times 100$              | 78%           | 42%                  |
| Koeficienti i qarkullimit              | $41,000/23,250$  | 1.8:1         | 1.6:1                |
| Kthimi në kapitalin e angazhuar (KNKA) | $26,750-14,500/59,000+25,000 +16,000+5,250 \times 100$ | 11.6%         | 17.9%                |
| Qarkullimi i pasurisë                  | $156,250/(123,250-23,250)$                             | 1.6 herë      | 1.9 herë             |

**(b) Analiza krahasuese e performancës dhe pozitës financiare.**

*Performanca financiare*

Koeficienti kryesor i rentabilitetit KNKA për Prizreni sh.a. nuk qendron mirë me konkurrentët e saj në sektor, pasi është 35% më i ulët për Prizreni sh.a në 11.6% krahasuar me 17.9% për kompanitë e sektorit (17.9% -11.6%/17.9). Zgjerimi i krahasimit me koeficientët e rentabilitetit, marzha e fitimit bruto të Prizreni sh.a është gjithashtu më e ulët se ajo e sektorit për 22% (22%-17%/22%). Marzha e fitimit neto për Prizreni sh.a është gjithashtu më e ulët se e sektorit për 32% (5%-3.4%/5%). Për më tepër, qarkullimi pasurive të Prizreni sh.a. është po ashtu i ulët krahasuar me sektorin për 16% (1.9%-1.6%/1.9). Nga të gjithë koeficientët e rentabilitetit, marzha e fitimit neto është kontribuesi më i keq pasi performanca e tij e dobët është më e ulëta nga të gjitha krahasuar me subjektet e sektorit, me 32% më të ulët. Kjo nënkupton që Prizreni sh.a mund të ketë pasur rritje të vëllimit të shitjeve për shkak të çmimeve të ulëta, por shpenzimet operative nuk u mbajtën nën kontroll, prandaj fitimi neto u përkeqësua shumë krahasuar me konkurrentët e saj. Për më tepër, KNKA më e ulët mund të nënkuptoj që proceset ose metodat e prodhimit të Prizreni sh.a. janë joefikase, duke sjellë kështu rritje të shpenzimeve operative.

Prizreni sh.a. po gjeneron afërsisht 11% (1.8%-1.6%/1.8%) më pak të hyra nga pasuritë e saj krahasuar me mesataren e sektorit, gjë që (siç është vënë re tashmë) po kontribuon në rentabilitetin e ulët të përgjithshme përmes KNKA-së.

Përveç provave të nën-shfrytëzimit të pasurive, Prizreni sh.a. ka faktorë të tjerë që ndikojnë në performancën e saj të dobët. Prizreni sh.a e rivlerësoi pronën e saj, ndërsa nuk dihet nëse konkurrentët e saj bënë të njëjtën gjë. Kjo ka një efekt artificial përkeqësues në KNKA, pasi rrit kapitalin e angazhuar, duke ulur kështu KNKA-në. Nëse konkurrentët e saj nuk kanë pasuri të rivlerësuar, rezultatet janë të pakrahasueshme me ato të Prizreni sh.a. Përveç kësaj, Prizreni sh.a. kohët e fundit bleu disa fabrika që mund të mos jenë në kapacitetin e plotë të prodhimit. Kjo do të thotë që kur fabrika të shfrytëzohet plotësisht, të hyrat dhe fitimi mund të përmirësohen.

### *Pozita financiare*

Leverazhi i Prizreni sh.a. është shumë i lartë, në 78%, krahasuar me 42% për sektorin. Kjo rrit kostot e financimit dhe e ekspozon kompaninë ndaj rreziqeve shumë të larta të falimentimit nëse nivelet e borxhit janë shumë të larta gjatë kohërave të vështira. Me mbulim interesi vetëm 2.7 herë, çdo rënie në fitim mund ta vendosë Prizreni sh.a-në në një pozicion të keq për sa i përket mbulimit të kostove të financimit dhe kryerjes së pagesave të kredisë. Kostoja e financimit të kredisë prej 10% është pak më e ulët se KNKA e Prizreni sh.a prej 11.6%. Prandaj, aksionarët po përfitojnë pak nga huamarrja, megjithëse me një rrezik të konsiderueshëm.

Koeficienti i qarkullimit tregon se likuiditeti i Prizreni sh.a është brenda normave të pritura dhe qendron mirë me konkurrentët e saj.

Fitimet për Aksion (FPA) janë shumë më të ulëta për shoqërinë Prizreni sh.a. në €0.23 krahasuar me sektorin në €0.80 për aksion. Kjo nënkupton që Prizreni sh.a. nuk realizoi shumë kthim për investimin e aksionarëve. Kjo mund të jetë për shkak të performancës së dobët të pasurive dhe rentabilitetit të dobët me rritjen e kostove të financimit që rrjedhin nga borxhi më i lartë për Prizreni sh.a.

### **Konkluzion**

Prizreni sh.a. ka një performancë dukshëm më të dobët krahasuar me subjektet e sektorit të saj dhe Drejtori Financiar ka të drejtë të deklarojë se krahasimi me konkurrentët e saj në sektor është mënyra më e mirë për të vlerësuar performancën e saj sesa të shikohet trendi i kaluar i performancës së saj. Është e rëndësishme të theksohet se performanca e Prizreni sh.a. mund të mos jetë plotësisht e krahasueshme nëse konkurrentët e sektorit përdorin politika të ndryshme kontabël për transaksione të ngjashme dhe përballen me rreziqe të ndryshme biznesi në mjediset në të cilat operojnë.

Prizreni sh.a ka disa mundësi të menjëhershme për ti marrë në konsideratë në mënyrë që të përmirësojë performancën. Mund të hartojë strategji për uljen e borxhit, të kontrollojë politikën e çmimeve dhe shkallën e shfrytëzimit të pasurive.